



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK
BASHKIA KUÇOVË

V E N D I M

Nr. 04, Datë 12.04.2022

MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 17, 56, 57 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 38, datë 22.04.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 12.04.2022.

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet me datë 22.04.2022.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës tek secili këshilltar, tek Kryetari i Bashkisë, Deputetët e Qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili Këshilltar dhe tek Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Migena BULLARI

